



## NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e enjte, në datën 17 dhjetor 2020, përmes mjeteve të komunikimit elektronik në distancë u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

|                |                   |                        |
|----------------|-------------------|------------------------|
| <b>Gentian</b> | <b>SALA</b>       | <b>Kryetar</b>         |
| <b>Sami</b>    | <b>NEZAJ</b>      | <b>Zëvendëskryetar</b> |
| <b>Agron</b>   | <b>GJEKMARKAJ</b> | <b>Anëtar</b>          |
| <b>Gledis</b>  | <b>GJIPALI</b>    | <b>Anëtar</b>          |
| <b>Suela</b>   | <b>MUSTA</b>      | <b>Anëtar</b>          |

AMA, pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë “Tema TV” sh.p.k., për subjektin audio privat “MCN Radio” nga “Qarqet Tiranë-Durrës” në “Qarku Tiranë” dhe zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit në “Qarqet Elbasan, Fier dhe Vlorë”. **(Vendimi nr. 146, datë 17.12.2020)**
2. Kalimin e të drejtave të autorizimit të shoqërisë “Abcom” sh.p.k., autorizuar për ofrimin e shërbimeve audiovizive tek shoqëria “Vodafone Albania” sh.a., për shkak të bashkimit me përthithje të shoqërisë “Abcom” sh.p.k. **(Vendimi nr. 147, datë 17.12.2020)**
3. Rinovimin e licencës së shoqërisë “4 Plus Media Group” sh.p.k., për subjektin audio privat “Radio 4+”. **(Vendimi nr. 148, datë 17.12.2020)**
4. Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë “Masa Grup 2009” sh.p.k., autorizuar për subjektin kabllor “Tv Kabllor Masa Grup”, në Njësinë administrative Pojan. **(Vendimi nr. 149, datë 17.12.2020)**
5. Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë “Libcom” sh.p.k., autorizuar për subjektin kabllor “Tv Kabllor Libcom”, në Njësitë administrative Librazhd dhe Tregan. **(Vendimi nr. 150, datë 17.12.2020)**
6. Konstatimin e pavlefshmërisë së autorizimit të subjektit person fizik Liberta Thanza, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor “Tv Kabllor Drini”. **(Vendimi nr. 152, datë 17.12.2020)**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 17 dhjetor 2020